
	Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve	PR-MO-007
	<i>vers. 2.0</i>	<i>Faqe 1 nga 15</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

**Operatori i Sistemit të Transmisionit
dhe Tregut të Kosovës
(KOSTT)**

**Procedura e Rregullave të Tregut për
Korrigjimin e Matjeve**

Qershor 2020

	Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve	PR-MO-007
	<i>vers. 2.0</i>	<i>Faqe 2 nga 15</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

Kjo procedurë e **Rregullave të Tregut** (duke përfshirë edhe amendamentet e mëvonshme) është përpiluar në përputhje me paragrafin 16.9.4 të **Rregullave të Tregut** që janë përgatitur në përputhje me Nenin 23 (paragrafi 7) të Ligjit Nr. 05/L -085 për Energjinë Elektrike.

Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve

1 Objektivat dhe Fushëveprimi


1.1 Objektivat

1.1.1 Kjo procedurë përcakton mënyrën e aplikimit e **Të Dhënave të Matjeve të Korrigjuara** për kalkulimin e korrigjimit të pagesave paraprake të **Barazimit Përfundimtar**.

1.2 Fushëveprimi

1.2.1 Në përputhje me paragrafin 16.9 të **Rregullave të Tregut**, **Pagesat pas Korrigjimit të Matjeve** do të kalkuloohen nga ana e **OT** duke aplikuar principet vijuese:

- (a) **Pagesa pas Korrigjimit të Matjeve** do të realizohet si një transfer financiar për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar** ku duhet të bëhet korrigjimi ndërmjet **Palës Tregtare (OST ose OSSH)** të regjistruar në **Sistemin Matës** relevant dhe të gjitha **Palëve Tregtare** tjera (**OST ose OSSH**) por nuk do të bëhen korrigjime për **Energjinë e Matur** të regjistruar në **Barazimin Përfundimtar**;
- (b) Të gjitha llogaritjet e bëra pas korrigjimeve, për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar** do të përdorin **Çmimin e Jobalancit** të përdorur paraprakisht në llogaritje;
- (c) Korrigjimi i **Të Dhënave Matëse të Njësisë Gjeneruese të kyçur në Rrjetin e Transmetimit** do të bëhet si **Pagesë pas Korrigjimit të Matjeve** ndërmjet **Palëve Tregtare** relevante dhe **Llogarisë Tregtuese të OST**;
- (d) Korrigjimi i **Të Dhënave Matëse të Rrjetit të Shpërndarjes** do të pasojë me **Pagesën pas Korrigjimit të Matjeve** ndërmjet **Llogarisë Tregtuese të OST** dhe **Llogarisë Tregtuese të OSSH-së**;
- (e) Korrigjimi i **Të Dhënave Matëse të Njësisë Gjeneruese të kyçur në Rrjetin e Shpërndarjes** do të bëhet si **Pagesë pas Korrigjimit të Matjeve** ndërmjet **Palëve Tregtare** relevante dhe **Llogarisë Tregtuese të OSSH**;


	Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve	PR-MO-007
	<i>vers. 2.0</i>	<i>Faqe 3 nga 15</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (f) Korrigjimi i **Të Dhënave Matëse** për **Sistemet Matëse Interval** të kyçura në transmetim do të rezultojë me **Pagesën pas Korrigjimit të Matjeve** ndërmjet **Palëve Tregtare** relevante dhe **Llogarisë Tregtuese të OST**;
- (g) Korrigjimi i **Të Dhënave Matëse** për **Sistemet Matëse Interval** të kyçura në shpërndarje do të rezultojë me **Pagesën pas Korrigjimit të Matjeve** ndërmjet **Llogarisë Tregtuese të OSSH** dhe **Furnizuesve** që kanë të regjistruar **Sisteme Matëse Interval**;
- (h) Korrigjimi i **Të Dhënave Matëse** për **Sistemet Matëse Jo-Interval** të kyçura në shpërndarje do të rezultojë me **Pagesën pas Korrigjimit të Matjeve** ndërmjet **Llogarisë Tregtuese të OSSH** dhe **Furnizuesve** që kanë të regjistruar **Sisteme Matëse Jo-Interval**;
- (i) Për **Sisteme Matëse Jo-Interval**:
 - (i) do të përdoret metodologjia për përcaktimin e energjisë në çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar** që përdorë **Sasinë Vjetore të Energjisë** të **Sistemit Matës** relevant që do të përcaktojë energjinë totale që i atribuohet **Sistemit Matës** individual nga **Barazimi Përfundimtar** dhe profilin e energjisë që u atribuohet të gjitha **Sistemeve Matëse Jo-Interval** (përfshirë këtu edhe **Sistemet Matëse të Furnizuesit Publik** të kyçura në shpërndarje) që përdoren për **Barazimin Përfundimtar** prej datës së fillimit deri në datën e përfundimit të periodës së korrigjimit të matjeve.
 - (ii) do të aplikohet proporcionalisht i njëjti profil për energjinë aktuale të matur si marrje ndërmjet datës së fillimit dhe datës së përfundimit për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar**.

1.3 Termat e përdorur në këtë Procedurë të Rregullave të Tregut

1.3.1 Termat në vijim do të përdoren në këtë Procedurë të Rregullave të Tregut:

- (a) **Korrigjimi i Matjeve** është proces mujor që realizohet nga ana e **OT** për korrigjimin e të gjitha **Të Dhënave Matëse** në atë muaj;
- (b) **Përpjesa e Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve** është përpjesa e çdo **Pagese pas Korrigjimit të Matjeve** në krahasim me një **Periodë të Barazimit Përfundimtar** që duhet t'i paguhet një **Pale Tregtare** ose duhet të paguhet nga një **Pale Tregtare** që ka të regjistruar **Sisteme Matëse Jo-interval**;
- (c) **Indeksi i Korrigjimit të Matjeve** është përpjesa e kalkuluar e **Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve** që duhet t'i bëhet një **Pale Tregtare** ose duhet të bëhet nga një **Pale Tregtare** (ose **Palët Tregtare**) për një **Periodë të Barazimit Përfundimtar** që rezulton nga një **Korrigjim i Matjeve** për një **Sistem Matës Jo-interval**;

	Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve	PR-MO-007
	<i>vers. 2.0</i>	<i>Faqe 4 nga 15</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

1.3.2 Të gjitha termet tjera në **bold** do të kenë të njëjtin kuptim sikurse termat e përdorura në legjislacionin në fuqi ose licenca, sipas rastit.

1.4 Principet e përgjithshme

1.4.1 **Korrigjimet e Matjeve** do të bëhen një herë në muaj si dhe do të realizohen në të njëjtën kohë me **Ekzekutimet e Barazimit Përfundimtar** final pa marrë parasysh periudhat kohore për të cilat janë bërë korrigjimet.

1.4.2 **Të Dhënat Matëse** të përdorura në **Barazimin Përfundimtar** gjatë **Ekzekutimit të Barazimit Përfundimtar** final të muajit paraprak do të përdoren si gjendje bazë gjatë procesit të **Korrigjimit të Matjeve** (korrigjimet për muajin aktual do të bëhen në **Barazimin Përfundimtar** të muajit të ardhshëm).


1.4.3 Të dhënat e reviduara do të regjistrohen si gjendje bazë për **Korrigjimin e Matjeve** të ardhshëm. **OT, AAM** dhe **ORr** relevant do të bëjnë korrigjimin e bazave të tyre.

1.4.4 Në përputhje me paragrafin 16.9.1 të **Rregullave të Tregut, OST, OSSh** ose **AAM** do të dorëzojnë; në baza mujore në formë të raportit **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** për çdo **Njehsorë** të kyçur në **Rrjetin Transmetimit** ose për çdo **Njehsorë** të kyçur në **Rrjetin e Shpërndarjes** për të cilët janë siguruar leximet (ose përafrimet më të mira) të ndryshme nga ato që tashmë janë përdorur në **Barazimin Përfundimtar**, dhe këto **Të Dhëna të Matjeve të Korrigjuara** mund të përfshijnë (si përcaktohet në paragrafin 16.9.3 të **Rregullave të Tregut**):

- (a) Identitetin e **Sistemit Matës** (gjenerim, kufi komercial ose furnizim);
- (b) Datën e fillimit dhe **Periodën e Barazimit Përfundimtar** për të cilën duhet të bëhet korrigjimi;
- (c) Datën e përfundimit dhe **Periodën e Barazimit Përfundimtar** për të cilën duhet të bëhet korrigjimi;
- (d) Energjinë paraprakisht të alokuar **Sistemit Matës** nga sistemi i **Barazimit Përfundimtar** prej datës së fillimit/ **Periodës së Barazimit Përfundimtar** deri në datën e përfundimit/ **Periodës së Barazimit Përfundimtar**;
- (e) **Energjinë e Matur** (ose të përafruar) si liferim ose si marrje në **Sistemin Matës** prej datës së fillimit/ **Periodës së Barazimit Përfundimtar** deri në datën e përfundimit/ **Periodës së Barazimit Përfundimtar**; dhe
- (f) Në qoftë se aplikohet, energjinë e përafruar që supozohet se është liferuar në **Sistemin Matës** prej datës së fillimit/ **Periodës së Barazimit Përfundimtar** deri në datën e përfundimit/ **Periodës së Barazimit Përfundimtar**.

1.4.5 **OT** dhe **AAM** do të mbajnë evidencë për çdo korrigjim të bërë, duke regjistruar:

- (a) Datën kur është bërë korrigjimi;

	Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve	PR-MO-007
	<i>vers. 2.0</i>	<i>Faqe 5 nga 15</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (b) **Periodën e Barazimit Përfundimtar** për të cilën është bërë korrigjimi;
- (c) **Sistemin Matës** për të cilin është bërë korrigjimi;
- (d) Të dhënat e regjistruara në **Gjendjen Bazë** përkatëse;
- (e) Të dhënat pas **Korrigjimit të Matjeve**.

1.4.6 Do të aplikohen principet e përcaktuara në paragrafin 1.2.1(a), në lidhje me korrigjimet e bëra si transfer financiar (pa ndryshuar shënimet për energjinë), dhe paragrafin 1.2.1(b), në lidhje me përdorimin e **Çmimit të Jobalancit** për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar** për caktimin e vlerës së **Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve**.


2 **Pagesa pas Korrigjimit të Matjeve për Njehsorë Interval**

2.1 **Të Dhënat Matëse të Njesisë Gjeneruese**

2.1.1 Kur **OST** (ose **OSSH**) konstaton që **Të Dhënat Matëse të Njesisë Gjeneruese** që ishin raportuar më parë tek **OT** nuk kishin saktësi të mjaftueshme, **OST** (ose **OSSH**) do të:

- (a) Diskutojë këtë çështje me **Palën Tregtare** tek e cila është e regjistruar **Njësia Balancuese** përkatëse në lidhje me llogaritjen e të gjithë parametrave relevant që duhet të përfshihen në raportin e **Të Dhënave të Matjeve të Korrigjuara**;
- (b) Dorëzojë tek **OT Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** në Ditën e 10 të muajit (por duhet të theksohet se në qoftë se informatat nuk janë të disponueshme për **Ekzekutimin e Barazimit Përfundimtar** të realizuar në Ditën e 10 të muajit, nuk përjashtohet mundësia e dorëzimit të informatave në muajin pasues);
- (c) Sigurojë **OT** se:
 - (i) **OST** (ose **OSSH**) dhe **Pala Tregtare** janë dakorduar për informatat; ose
 - (ii) **OST** (ose **OSSH**) nuk ka qenë në gjendje të dakordohet me **Palën Tregtare** për informatat përkatëse, por sipas njohurive që posedon konsideron se korrigjimi duhet të bëhet; ose
 - (iii) Pas një **Kontesti**, autoriteti përkatës (duke përfshirë gjyqet ose **ZRrE**) ka udhëzuar për një ndryshim të tillë.

2.1.2 Duke u bazuar në **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** të dorëzuara, **OT** do të kalkulojë për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar "j"** që përfshihet në **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** të një **Njësie Gjeneruese "b"** (të regjistruar tek **Pala Tregtare "A"**), **Pagesën pas Korrigjimit të Matjeve** (PKM_{Abj}) dhe **Pagesën pas Korrigjimit të Matjeve** totale (PKM_{Ab}) për **Njësinë Gjeneruese** për një periodë të korrigjimit me formulën:

	Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve	PR-MO-007
	<i>vers. 2.0</i>	<i>Faqe 6 nga 15</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

$$PKM_{Abj} = \zeta_j * \left(\frac{ENjG'_{Ab} - \sum_{i=1}^n ENjG_{Abi}}{n} \right)$$

$$PKM_{Ab} = \sum_{i=1}^n PKM_{Abi}$$

Ku:

n është numri i **Periodave të Barazimit Përfundimtar** ndërmjet datës së fillimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** dhe datës së përfundimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** në **Të Dhënat Matëse të Korrigjuara** të dorëzuara nga **OST** (ose **OSSH**);

ζ_j është **Çmimi i Jobalancit** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar "j"**;

$ENjG'_{Ab}$ është **Energjia e Matur e Njesisë Gjeneruese** e kalkuluar si liferim aktual nga **Njësia Gjeneruese "b"** e regjistruar në **Llogarinë e Injektivit "A"** ndërmjet datës së fillimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** dhe datës së përfundimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** në përputhje me **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara**;


$ENjG_{Abi}$ është **Energjia e Matur e Njesisë Gjeneruese** që fillimisht ishte regjistruar si liferim në **Periodën e Barazimit Përfundimtar "i"** për **Njësia Gjeneruese "b"** i regjistruar në **Llogarinë e Injektivit "A"** para korrigjimit.

2.1.3 Kur shuma e **Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve** është më e madhe se zero, atëherë **OT** do të kreditojë **Llogarinë e Injektivit të Palës Tregtare "A"** me shumën e **Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve** dhe debitojë të njëjtën vlerë nga **Llogaria Tregtuese të OST** (ose **Llogarinë Tregtuese të OSSH**), në të kundërtën **OT** do të debitojë shumën e **Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve** nga **Llogaria e Injektivit të Palës Tregtare "A"** dhe do të kreditojë **Llogarinë Tregtuese të OST** (ose **Llogarinë Tregtuese të OSSH**).

2.2 Të Dhënat Matëse të Rrjetit të Shpërndarjes

2.2.1 Kur **OST** konstaton që **Energjia e Matur e Rrjetit të Shpërndarjes (EZ_{oj})** për një **Sistem Matës "o"** në **Kufirin Komercial** ndërmjet **Rrjetit të Transmetimit** dhe **Rrjetit të Shpërndarjes**, që më parë ishin raportuar tek **OT** nuk kanë saktësi të mjaftueshme, **OST** do të:

- (a) Diskutojë këtë çështje me **Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes** në lidhje me përafrimet e të gjitha parametrevë që duhet të përfshihen në raportin e **Të Dhënave të Matjeve të Korrigjuara**;

	Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve	PR-MO-007
	<i>vers. 2.0</i>	<i>Faqe 7 nga 15</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (b) Dorëzohet **OT Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** në Ditën e 10-të të muajit (por duhet të theksohet se në qoftë se informatat nuk janë të disponueshme për **Ekzekutimin e Barazimit Përfundimtar** të realizuar në Ditën e 10 të muajit, nuk përjashtohet mundësia e dorëzimit të informatave në muajin pasues);
- (c) Sigurojë **OT** se:
- (i) **OST** dhe **Operatori i Sistemit të Shpërndarjes** janë dakorduar për informatat; ose
 - (ii) **OST** nuk ka qenë në gjendje të dakordohet me **Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes** për informatat përkatëse, por sipas eksperiencës që posedon konsideron se korrigjimi duhet të bëhet; ose
 - (iii) Pas një **Kontesti**, autoriteti relevant (duke përfshirë gjyqet ose **ZRrE**) ka udhëzuar një ndryshim të tillë.


2.2.2 Duke u bazuar në **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara**, **OT** do të kalkulojë për **Sistemin Matës Pagesën pas Korrigjimit të Matjeve** (PKM_{Abj}) dhe shumën totale të **Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve** (PKM_{Ab}) për **Njësinë Balancuese** përkatëse “b” (të regjistruar tek **Pala Tregtare “A”**), për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar “j”** të përfshirë në **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** për një periodë të korrigjimit me formulën:

$$PKM_{Abj} = \zeta J_j * \left(\frac{EZ'_o - \sum_{i=1}^n EZ_{oi}}{n} \right)$$

$$PKM_{Ab} = \sum_{i=1}^n PKM_{Abi}$$

Ku:

- n është numri i **Periodave të Barazimit Përfundimtar** ndërmjet datës së fillimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** dhe datës së përfundimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** në **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** të dorëzuara nga **OST**;
- ζJ_j është **Çmimi i Jobalancit për Periodën e Barazimit Përfundimtar “j”**;
- EZ'_o është energjia e kalkuluar si liferim aktual në **Sistemin Matës të Rrjetit të Shpërndarjes “o”** ndërmjet datës së fillimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** dhe datës së përfundimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** në përputhje me **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara**;

	Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve	PR-MO-007
	<i>vers. 2.0</i>	<i>Faqe 8 nga 15</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

EZ_{oi} është **Energjia e Matur e Rrjetit të Shpërndarjes** që fillimisht ishte regjistruar si liferim në **Sistemet Matëse të Rrjeteve të Shpërndarjes "o"** në **Periodën e Barazimit Përfundimtar "i"** para korrigjimit.

2.2.3 **Energjia e Matur e Rrjetit të Shpërndarjes në Barazimin Përfundimtar** regjistrohet me vlerë negative (që do të thotë se është energjia që rrjedh nga **Rrjeti i Transmetimit**).


2.2.4 Kur shuma totale e **Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve** është më e madhe se zero, atëherë **OT** do të debitojë **Llogarinë Tregtuese të OST** me shumën totale të **Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve** dhe do të kreditojë me të njejtën vlerë **Llogarinë Tregtuese të OSSh "A"**, në të kundërtën **OT** do të kreditojë **Llogarinë Tregtuese të OST** me shumën totale të **Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve** dhe do të debitojë **Llogarinë Tregtuese të OSSh "A"**.

2.3 Njehsorët e Konsumatorëve të Kyçur në Transmetim

2.3.1 Kur **OST** konstaton që **Energjia e Matur e Njësisë Furnizuese në Sistemet Matëse të Konsumatorëve** të kyçur në transmetim që ishte raportuar më parë tek **OT** nuk kishin saktësi të mjaftueshme, **OST** do të:

- (a) Diskutojë këtë çështje me **Palën Tregtare** tek e cila është e regjistruar **Sistemi Matës** përkatës në lidhje me llogaritjen e të gjithë parametrave relevant që duhet të përfshihen në raportin e **Të Dhënave të Matjeve të Korrigjuara**;
- (b) Dorëzojë tek **OT Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** në Ditën e 10 të muajit (por duhet të theksohet se në qoftë se informatat nuk janë të disponueshme për **Ekzekutimin e Barazimit Përfundimtar** të realizuar në Ditën e 10 të muajit, nuk përjashtohet mundësia e dorëzimit të informatave në muajin pasues);
- (c) Sigurojë **OT** se:
 - (i) **OST** dhe **Pala Tregtare** janë dakorduar për informatat; ose
 - (ii) **OST** nuk ka qenë në gjendje të dakordohet me **Palën Tregtare** për informatat relevante, por sipas eksperiencës që posedon konsideron se korrigjimi duhet të bëhet; ose
 - (iii) Pas një **Kontesti**, autoriteti relevant (duke përfshirë gjyqet ose **ZRrE**) ka udhëzuar një ndryshim të tillë.

2.3.2 Duke u bazuar në **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara**, **OT** do të kalkulojë për **Njësinë Balancuese, Pagesën pas Korrigjimit të Matjeve** (PKM_{Abj}) dhe shumën totale të **Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve** (PKM_{Ab}) për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar "j"** të përfshirë në **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** në raport me **Sistemin Matës** relevant "**b**" (të regjistruar tek **Pala Tregtare "A"**), dhe për një periudhë të korrigjimit me formulën:

	Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve	PR-MO-007
	<i>vers. 2.0</i>	<i>Faqe 9 nga 15</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

$$PKM_{Abj} = \zeta J_j * \left(\frac{EF'_{Ab} - \sum_{i=1}^n EF'_{Abi}}{n} \right)$$

$$PKM_{Ab} = \sum_{i=1}^n PKM_{Abi}$$

Ku:

n është numri i **Periodave të Barazimit Përfundimtar** ndërmjet datës së fillimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** dhe datës së përfundimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** në **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** të dorëzuara nga **OST**;

ζJ_j është **Çmimi i Jobalancit për Periodën e Barazimit Përfundimtar "j"**;

EF'_{Ab} është **Energjia e Matur e Njesisë Furnizuese** e kalkuluar si marrje aktuale nga **Sistemi Matës i Konsumatorit "b"** të kyçur në transmetim të regjistruar në **Llogarinë Dalëse "A"** ndërmjet datës së fillimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** dhe datës së përfundimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** në **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara**;


EF_{Abi} është **Energjia e Matur e Njesisë Furnizuese** që fillimisht ishte regjistruar si marrje në **Periodën e Barazimit Përfundimtar "i"** të **Sistemit Matës "b"** të **Konsumatorit** të kyçur në transmetim të regjistruar në **Llogarinë Dalëse "A"** para korrigjimit.

2.3.3 **Energjia e Matur e Njesisë Furnizuese në Barazimin Përfundimtar** regjistrohet me vlerë negative (që do të thotë se energjia del nga **Rrjeti i Transmetimit**) ashtu që kur shuma totale e **Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve** është më e madhe se zero, **OT** do të debitojë **Llogarinë Tregtuese të OST** me shumën totale të **Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve** dhe do të kreditojë me të njejtën vlerë **Llogarinë Dalëse të Palës Tregtare "A"**, në të kundërtën **OT** do të kreditojë **Llogarinë Tregtuese të OST** me shumën totale të **Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve** dhe do të debitojë **Llogarinë Dalëse të Palës Tregtare "A"**.

2.4 Sistemet Matëse Interval të Konsumatorëve të Kyçur në Shpërndarje

2.4.1 Kur **AAM** konstaton që **Energjia e Matur e Njesisë Furnizuese** në një **Sistem Matës Interval** të kyçur në shpërndarje, që më parë i ishte raportuar **OT** nuk ka saktësi të mjaftueshme, **AAM** do të:

- (a) Diskutojë këtë çështje me **Palën Tregtare** tek e cila është i regjistruar **Sistemi Matës** përkatës në lidhje me llogaritjen e të gjithë parametrave relevant që duhet të përfshihen në raportin e **Të Dhënave të Matjeve**;

	Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve	PR-MO-007
	<i>vers. 2.0</i>	<i>Faqe 10 nga 15</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (b) Dorëzohet tek OT për nevoja të **Barazimit Përfundimtar Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** në Ditën e 10 të muajit (por duhet të theksohet se në qoftë se informatat nuk janë të disponueshme për **Ekzekutimin e Barazimit Përfundimtar** të realizuar në Ditën e 10 të muajit, nuk përjashtohet mundësia e dorëzimit të informatave në muajin pasues);
- (c) Sigurojë OT se:
- (i) **AAM** dhe **Pala Tregtare** janë dakorduar për informatat; ose
 - (ii) **AAM** nuk ka qenë në gjendje të dakordohet me **Palën Tregtare** për informatat relevante, por sipas eksperiencës që posedon konsideron se korrigjimi duhet të bëhet; ose
 - (iii) Pas një **Kontesti**, autoriteti relevant (duke përfshirë gjyqet ose **ZRrE**) ka urdhëruar një ndryshim të tillë.


2.4.2 Duke u bazuar në **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara**, OT do të kalkulojë **Pagesën pas Korrigjimit të Matjeve** (PKM_{Abj}) dhe shumën totale të **Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve** (PKM_{Ab}) për **Njësinë Balancuese** për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar "j"** të përfshirë në **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** në raport me **Sistemin Matës** relevant "**b**" (të regjistruar tek **Pala Tregtare "A"**), për një periodë të korrigjimit me formulën:

$$PKM_{Abj} = \zeta J_j * \left(\frac{EF'_{Ab} - \sum_{i=1}^n EF_{Abi}}{n} \right)$$

$$PKM_{Ab} = \sum_{i=1}^n PKM_{Abi}$$

Ku:

- n është numri i **Periodave të Barazimit Përfundimtar** ndërmjet datës së fillimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** dhe datës së përfundimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** në **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** të dorëzuara nga **AAM**;
- ζJ_j është **Çmimi i Jobalancit** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar "j"**;
- EF'_{Ab} është **Energjia e Matur e Njësisë Furnizuese** e kalkuluar si marrje aktuale nga **Sistemi Matës Interval "b"** të kyçur në shpërndarje të regjistruar në **Llogarinë Dalëse "A"** ndërmjet datës së fillimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** dhe datës së përfundimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** në **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara**;

	Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve	PR-MO-007
	<i>vers. 2.0</i>	<i>Faqe 11 nga 15</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		


EF_{Abi} është **Energjia e Matur e Njesisë Furnizuese** që fillimisht ishte regjistruar si marrje në **Periodën e Barazimit Përfundimtar "I"** për **Sistemet Matëse "b"** të **Konsumatorëve** të kyçur në shpërndarje të regjistruar në **Llogarinë Dalëse "A"** para korrigjimit.

- 2.4.3 **Energjia e Matur e Njesisë Furnizuese** në **Barazimin Përfundimtar** regjistrohet me vlerë negative (që do të thotë se është energji që rrjedh nga **Rrjeti i Transmetimit**).
- 2.4.4 Kur shuma totale e **Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve** është më e madhe se zero, atëherë **OT** do të debitojë **Llogarinë Dalëse të Palës Tregtare "A"** me shumën totale të **Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve** dhe do të kreditojë me të njëjtën vlerë **Llogarinë Tregtare të OSSh** në të kundërtën **OT** do të kreditojë **Llogarinë Dalëse të Palës Tregtare "A"** me shumën totale të **Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve** dhe do të debitojë **Llogarinë Tregtare të OSSh**.
- 2.4.5 Neni 2.4 aplikohet për **Njësitë Gjeneruese** të kyçura në shpërndarje kur **Sistemi Matës** është **Sistem Matës Interval** për të cilin janë dorëzuar **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara**, dhe kushtet do të aplikohen sikur **Prodhuesi** të ishte **Konsumator** por me ndryshimet vijuese:
- (a) **Llogaria e Palës Tregtare** do të jetë **Llogari e Injektimit**; dhe
 - (b) **Energjia e Matur e Njesisë Gjeneruese** do të referohet si **Energji e Matur e Njesisë Furnizuese**.

3 Pagesat pas Korrigjimit të Matjeve të Njehsorëve Jo-interval

3.1 Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara për Sistemet Matëse Jo-Interval

- 3.1.1 Në përputhje me paragrafin 16.4.3 e **Rregullave të Tregut**, **OT** nuk do të regjistrojë ndaras **Energjinë e Matur të Njesisë Furnizuese** për çdo **Sistem Matës Jo-Interval** individual, prandaj **AAM** duhet të kalkulojë energjinë që i atribuohet **Sistemit Matës Jo-Interval** për të gjitha **Periodat e Barazimit Përfundimtar** ndërmjet datës së fillimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** dhe datës së përfundimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** në **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** që i janë dorëzuar **AAM**.
- 3.1.2 Çdo muaj deri në M+60 ditë **OSSH** do t'i dorëzojë **AAM Të Dhënat Matëse të Korrigjuara** nga **Ekzekutimi i Barazimit Përfundimtar** të fundit për çdo **Sistem Matës Jo-Interval** të regjistruara te ndonjë furnizuese tjetër që nuk është **Furnizues Publik**.
- 3.1.3 Çdo muaj deri në M+60 ditë **OSSH** do të dorëzojë **AAM Të Dhënat Matëse të Korrigjuara** si shumë totale e **Sistemeve Matëse Jo - intervale dhe Intervale** që janë të regjistruar te **Furnizuesi Publik**.
- 3.1.4 Në rastin kur **OSSH** dorëzon **Të Dhënat Matëse të Korrigjuara** në përputhje me paragrafin 3.1.3 atëherë **OT** do të kalkulojë **Pagesën pas Korrigjimit të Matjeve** (PKM_{Abj}) dhe shumën totale të **Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve** (PKM_{Ab}) për të

	Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve	PR-MO-007
	<i>vers. 2.0</i>	<i>Faqe 12 nga 15</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

gjithë **Sistemet Matëse Interval dhe Jo Interval** të regjistruar të **Furnizuesit Publik** me formulën:


$$PKM_{Abj} = \zeta_j * \left(\frac{EF'_{Ab} - \sum_{i=1}^n EF_{Abi}}{n} \right)$$

$$PKM_{Ab} = \sum_{i=1}^n PKM_{Abi}$$

Ku:

- n është numri i **Periodave të Barazimit Përfundimtar** ndërmjet datës së fillimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** dhe datës së përfundimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar në Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** të dorëzuara nga **AAM**;
- ζ_j është **Çmimi i Jobalancit për Periodën e Barazimit Përfundimtar "j"**;
- EF'_{Ab} është **Energjia e Matur e Njesisë Furnizuese e Furnizuesit Publik** e dorëzuar nga **OSSH** në përputhje me paragrafin 3.1.3 e kalkuluar si marrje aktuale nga të gjitha **Sistemet Matës Interval dhe Jo Interval** të kyçur në shpërndarje të regjistruar në **Llogarinë Dalëse të Furnizuesit Publik** ndërmjet datës së fillimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** dhe datës së përfundimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar në Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara**;
- EF_{Abi} është **Energjia e Matur e Njesisë Furnizuese** që fillimisht ishte regjistruar si marrje në **Periodën e Barazimit Përfundimtar "i"** për **Sistemet Matëse "b"** të **Konsumatorëve** të kyçur në shpërndarje të regjistruar në **Llogarinë Dalëse "A"** para korrigjimit.

- 3.1.5 **Energjia e Matur e Njesisë Furnizuese në Barazimin Përfundimtar** regjistrohet me vlerë negative (që do të thotë se është energji që rrjedh nga **Rrjeti i Transmetimit**).
- 3.1.6 Kur shuma totale e **Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve** është më e madhe se zero, atëherë **OT** do të debitojë **Llogarinë Dalëse të Palës Tregtare "A"** me shumën totale të **Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve** dhe do të kreditojë me të njëjtën vlerë **Llogarinë Tregtare të OSSH** në të kundërtën **OT** do të kreditojë **Llogarinë Dalëse të Palës Tregtare "A"** me shumën totale të **Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve** dhe do të debitojë **Llogarinë Tregtare të OSSH**.
- 3.1.7 Në **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** të referuara në paragrafin 3.1.2, energjia e matur si marrje nga **Sistemi Matës** siç referohet në paragrafin 1.4.4(e) do të kalkulohej nga ana e **OSSH** duke zbritur shumën e energjisë së regjistruar në çdo **Njehsorë të Sistemit Matës** në datën e leximeve paraprake të **Njehsorit(ëve)** nga shuma e energjisë së regjistruar gjatë leximeve të fundit të **Njehsorit(ëve)**.

	Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve	PR-MO-007
	<i>vers. 2.0</i>	<i>Faqe 13 nga 15</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- 3.1.8 Për nevoja të kalkulimit të **Korrigjimit të Matjeve**, koha në ditën në të cilën janë bërë leximet e (i parafundit dhe i fundit) **Njehsorit(ëve)** supozohet të jetë në përfundimin e periodës së fundit të **Barazimit Përfundimtar** të ditës kur janë bërë leximet.
- 3.1.9 Gjatë dorëzimit të **Të Dhënave të Matjeve të Korrigjuara** për **Sistemet Matëse Jo-Interval**, **OSSH** duhet t'i garantojë **AAM** se ka bërë përpjekjet më të mira që të dorëzojë të dhënat më të sakta.

3.2 Indeksi i Korrigjimit të Matjeve

- 3.2.1 **OT** do të regjistrojë vlerën totale të energjisë që u alokohet këtyre **Sistemeve Matëse Jo-Interval** për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar** që përfshijnë **Sistemet Matëse Jo-Interval** gjatë të gjitha **Ekzekutimeve të Barazimit Përfundimtar** relevant dhe do ta njoftojë **AAM** për këto shuma.
- 3.2.2 **AAM** do të formojë një **Indeks të Korrigjimit të Matjeve** (IKM_{bj}) për çdo **Sistem Matës Jo-Interval "b"** për të cilin **AAM** ka **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** e për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar** ndërmjet datës së fillimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** dhe datës së përfundimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** në **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** me formulën:


$$IKM_{bj} = \frac{ET_j}{\sum_{i=1}^n ET_i}$$

Ku:

- n është numri i **Periodave të Barazimit Përfundimtar** ndërmjet datës së fillimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** dhe datës së përfundimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** në **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** të dorëzuara nga **AAM**;
- i është **Perioda e Barazimit Përfundimtar** ndërmjet datës së fillimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** dhe datës së përfundimit / **Periodës së Barazimit Përfundimtar** në **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** që i dorëzohen **AAM**;
- ET_i është energjia totale që i alokohet të gjithë **Sistemeve Matëse Jo-Interval** në **Periodën e Barazimit Përfundimtar i**.

3.3 Kalkulimi i Korrigjimit të Matjeve për Sisteme Matëse Jo-interval

- 3.3.1 Duke u bazuar në **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara**, **AAM** do të kalkulojë dhe dorëzojë **OT**, për çdo **Periodë të barazimit Përfundimtar "j"** që përfshihet në **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** në raport me **Sistemin Matës** relevant "**b**" (që është i regjistruar tek **Pala Tregtare "A"**), **Pagesën pas Korrigjimit të Matjeve** (PKM_{Abj}) dhe

	Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve	PR-MO-007
	<i>vers. 2.0</i>	<i>Faqe 14 nga 15</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve totale (PKM_{Ab}) për **Sistemin Matës** në një periudhë të korrigjimit me formulën:


$$PKM_{Abj} = \zeta J_j * IKM_{bj} * \left(EF'_{Ab} - \sum_{i=1}^n EF_{Abi} \right)$$

$$PKM_{Ab} = \sum_{i=1}^n PKM_{Abi}$$

Ku:

- n është numri i **Periodave të Barazimit Përfundimtar** ndërmjet datës së fillimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** dhe datës së përfundimit/**Periodës së Barazimit Përfundimtar** në **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** të dorëzuara nga **AAM**;
- ζJ_j është **Çmimi i Jobalancit** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar "j"**;
- IKM_{bj} është **Indeksi i Korrigjimit të Matjeve** i kalkuluar në përputhje me paragrafin 3.2.2
- EF'_{Ab} është **Energjia e Matur e Njesisë Furnizuese** e kalkuluar si marrje aktuale për sistemin matës jointerval
- EF_{Abi} është **Energjia e Matur e Njesisë Furnizuese** e regjistruar fillimisht si marrje në **Periodën e Barazimit Përfundimtar "i"** për **Sistemet Matëse të Konsumatorëve** të kyçur në shpërndarje "b" të regjistruar në **Llogarinë Dalëse "A"** para korrigjimit.

- 3.3.2 **Energjia e Matur e Njesisë Furnizuese** në **Barazimin Përfundimtar** regjistrohet me vlerë negative (që do të thotë se është energji që rrjedh nga **Rrjeti i Transmetimit**).
- 3.3.3 Kur **Pagesa pas Korrigjimit të Matjeve** totale është më e madhe se zero, atëherë **OT** do të debitojë **Llogarinë Dalëse të Palës Tregtare "A"** me shumën totale të **Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve** dhe do të kreditojë me të njëjtën vlerë **Llogarinë Dalëse të Furnizuesit Publik**, në të kundërtën **OT** do të kreditojë **Llogarinë Dalëse të Palës Tregtare "A"** me shumën totale të **Pagesës pas Korrigjimit të Matjeve** dhe do të debitojë **Llogarinë Dalëse të Furnizuesit**.
- 3.3.4 Neni 3.3 aplikohet për **Njësitet Gjeneruese** të kyçura në shpërndarje ku **Sistemet Matëse** janë **Sisteme Matëse Jo-Interval** për të cilat dorëzohen **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara**, dhe të gjitha kushtet do të aplikohen sikur **Prodhuesi** të ishte një **Konsumator** por **Energjia e Matur e Njesisë Gjeneruese** do të përdoret aty ku **Energjia e Matur e Njesisë Furnizuese** është referuar.

	Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve	PR-MO-007
	<i>vers. 2.0</i>	<i>Faqe 15 nga 15</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

4 Barazimi Përfundimtar pas Korrigjimit të Matjeve

4.1 Informatat Përcjellëse të Faturave

4.1.1 Për të mbështetur **Rreshtat e Faturave** në lidhje me **Pagesat pas Korrigjimit të Matjeve** në **Faturat** që **OT** i dorëzon **Palëve Tregtare**, duhet të aplikohen rregullat vijuese në lidhje me informatat që duhet të dorëzohen nga **OT**:

- (a) Kur një **Palë Tregtare** ka të regjistruar ndonjë **Sistem Matës Interval** (duke përfshirë **Sistemin Matës të Njesisë Gjeneruese**) për të cilin **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** janë dorëzuar, atëherë të gjitha **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** do t'i dorëzohen **Palës Tregtare**;
- (b) Kur një **Palë Tregtare** ka të regjistruar ndonjë **Sistem Matës Jo-Interval** për të cilin **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** janë dorëzuar, atëherë **OT** do të sigurojë të dhënat vijuese:
 - (i) Datën më të hershme dhe datën më të vonshme për të cilat janë bërë korrigjime;
 - (ii) Numrin e **Sistemeve Matëse Jo-Interval** të regjistruar tek **Pala Tregtare** për të cilat janë bërë korrigjime;
 - (iii) Energjinë neto (pozitive ose negative) të këtyre njehsorëve;
- (c) Kur një **Palë Tregtare** (duke përfshirë edhe **Furnizuesin Publik**) përfshihet në **Pagesat pas Korrigjimit të Matjeve** që rezultojnë nga **Korrigjimet e Matjeve** të bëra për një **Sistem Matës** që nuk është i regjistruar tek ajo **Palë Tregtare** atëherë **OT** do të sigurojë të dhënat vijuese:
 - (i) Datën më të hershme dhe datën më të vonshme për të cilat janë bërë korrigjime;
 - (ii) Energjinë neto (pozitive ose negative) për **Palën Tregtare**;
 - (iii) **Përpjesën e Sistemit Matës të Furnizuesit të Palës Tregtare.**